



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

---

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 02-0601/01**

**Pejë, datë: 16 prill 2024**

**P R O C E S V E R B A L**

Nga takimi i IV- i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **16 prill 2024**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, drejtororeshë e administrates, znj.Nita Panduri, zyrtarja kryesore e financave. znj. Hajrie Haxhijaj, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, znj.Donjeta Morina, zyrtare administrative, dhe përfaqësuesit e ZIP-it dhe OSBE.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtaret prezent u miratua ky rend dite, me 9 vota pro, kundër nuk ka, të përbajtj nuk ka.

## Rendi i Ditës

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 18.03.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.
5. Bartja (rialokimi) i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 ne vitin 2024.
6. Informat mbi listen komunale dhe menaxhimin e tyre.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.
8. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

### **1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 18.03.2024**

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt.18.03.2024.

### **3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ky material ka ardh nga drejtoria e zhvillimit ekonomik e keni mar, fillimishtë në seancën e parë votohet me parim në diskutim publik, pastaj në aprovim, nese ka dikush diskutim për ketë pikë po e hapim debatin!

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhënie në diskutim publik i Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028.

### **4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.**

Znj.Hajrije Haxhijaj: plani i të hyrave për vitin 2024 ka qenë i planifikuar 5,200, 496.85 euro, ku përfat të mirë ne kemi pas një tejkalim të planit të të hyrave 6,207,537.60, ku pjesë e tejkalimit të hyrat vetanake por edhe një shumë të madhe tejkalimi nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykata, që është një shumë prej 1,007,040.75. Kemi marr parasysh se keto të hyra që i këmi tejkalu, në vitin 2023 nuk kemi pas mundësi me i shfrytëzu në muajt që kemi pas mundësi me bo tejkalimin e planit. Athere ne duhet të bëjmë tash një ribuxhetim të mjeteve, programeve, projekteve të cilat i këmi prezantu në tabele. Unë, po i prezentoj dy pikat edhe Bartja(rialokimi) i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 në vitin 2024, tash me ligjin e ri të vitit 2024 neni 9 i ligjit të buxhetit e parashev kur bartja e të hyrave të pa shpenzuara shuma pre 592,286.43 euro, bëhet bartja direkte prej ministrisë dhe departametit të buxhetit dhe thesarit. Mundësia jonë e vetme që kemi na mund të bëjmë rialokim të ketyre mjeteve në projektet që kanë mungesë të buxhetit të vitit 2023. Ku rasti tek ne është drejtoria e kultures prej projektit Instalimi i ngrohjes qendrore dhe ventilimit në palestrën Karagaq” bartja në ketë projekt është ë shumën 200 mijë

euro, ne kemi bë kërkesë për rialokim në shumën prej 102,810.00€. Në dy projektet në "Rregullimi i Galerisë së Arteve " shuma prej 62,848.00€ " dhe Blerja e arenës profesionale për boks si dhe skenës profesionale për ambiente të hapurave' ne shume prej 39,312.00€. Ju keni qenë edhe me heret kur është bë bartja e mjeteve, e tani ministria direkt e bën bartjen vetem ne mundemi me bo ndryshime rialokim apo transfer sepse bartja nuk na lejohet.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro, 2 votë kundër, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim rekomandimi i buxhetimit të tejkalimit të planit të të hyrave.

#### **5.Bartja (rialokimi) i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 ne vitin 2024.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: znj. Hajrije i jepi sqarimet e nevojshme edhe për ketë pikë

Nga të gjithë anëtaret prezent me 4 votë pro, 2 votë kundër, 2 votë të përmbatur, i rekomandohet kuvendit bartja (rialokimi) i mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2023 ne vitin 2024.

#### **6.Informat mbi listen komunale dhe menaxhimin e tyre.**

z.Berat Ganiqi: ne vetem e kemi të shkruar sa kanë gjeneru por nuk e kemi të shkruar se sa gjenerohet në vit për secilen parcelë, ngastër që e kanë jep në shfrytëzim. Po ashtu edhe kjo është një mungesë e trasnparencës për neve si asambleistë, pasi që përfshijnë vetem shuma të përgjithshme, e jo shuma për me dit se sa janë jep me qirra, kjo tregon edhe një here mungenë e transparencës në komunën e Pejës .

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro (votim dyfishtë të kryesusit), 4 votë kundër, me votim dyfishtë të kryesusit i rekomandohet kuvendit Informata mbi listen komunale dhe menaxhimin e tyre.

#### **7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.**

Znj.Nita Panduri: fillimishtë kërkoj falje që raporti është dërgu me vonësë, por është problem prej 30 kryetarëve të këshillave lokat të meret një pasqyrim të drejtë të punës për periudhen që flitet. Po ashtu ju e dini sepse e keni punu bashkë planin e punës ju asambleistet, së bashku me kryesusin. Po ashtu në seancën e fundit që e kemi mbajt në kuvend shumica prej asambleistëve kanë reagu për atë se qka paraqesin në raport, ta keni parsysh se është vetem një informatë mbi funksionimin e këshillave lokal dhe ata kanë paraqitur se sa kërkesa janë, dhe sa është puna e tyre i përbledhur në ketë raport. Ne si komunë dhe administratë i kemi të gjitha takimet e detajuara, janë edhe kërkesat që mundeni edhe përmes protokollit të keni qasje në dokumenta! Por është e pamunudr prej 30 kryetarë të këshillave lokan në një raport me i paraqit të gjitha kërkesat sespe del edhe jasht parimit të rapportit, edhe pse është informatë mirpo unë e them si rapport për shkak se i tillë duhet të jet. Çështja tjeter është se ne e kemi pak problem kompenzimin e ketyre kryetarëve të këshillave lokal, në ketë pikë ta thjeshtë janë duke punuar në fazë vullnetare, dhe unë e shoh shumë normale dhe njerzore sigurishtë duhet me kontribu edhe për qytetin dhe për ketë duhet me u vlersu dhe gjithmonë ka vend për përmisime.

z.Berat Ganiqi: në ketë rapport po shoh vetem kërkesa drejtuar komunës, sa prej tyre kërkesave janë realizu dhe cilat kanë qenë ato kërkesa? Dhe një pyetje sa i përket kryetarëve të këshillave

lokal, këta kryetar që kanë marr poste në LDK a janë duke e respektuar ligjin, a kanë jep dorëheqje, apo janë duke i mbajtur dy poste? A kanë jep dorëheqje sepse janë duke e shkelur ligjin, dhe prej sotit mo nuk kam me leju me shkel ligjin, për çdo send ka me pas argument mbi argument, sepse na keni akuzu që po dërgojmë në prokurori në momentin që ju dërgoj nuk ka me dal kush nga aty po ju garantoj, siq disa nuk janë duke dal!

Znj.Hidajete Nikqi: meqeneëse heren e kaluar kam kërkuar që këto procesverbale të kenë edhe fotografî, që ta ken si dëshmi të takimeve të këshillave lokal, a ju kanë bashkangjit fotografitë?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kryetarët e këshillave lokal kur kan kandidu për kryetar e kanë pas parasysh që edhe pagesa ka qenë e vogël, në krahasim me angazhimin që kanë me pas dhe punë e vazhdushme. Me ligjin e vjetër me udhëzim administrativ, ministria e ka bo propozimin që komuna me bo kompenzimin e tyre. Pastaj me hyrjen në fuqi të ligjit të ri ato kanë ra posht edhe ato udhëzime administrative nuk kem pas formë ose mundësi se qysh duhet me i kompenzu. E dim që është mbet keq qe spo mundem me i kompenzu, së paku disa shpenzime që i bëjnë gjatë aktiviteteve të mbulohen dhe kish me qenë në rregullë.

Znj.Nita Panduri: sa i perket kërkësave shihet në tabelen e fundit, ky është një raport 6 mujor dhe sipas rregullores obligative e kanë me i mbajt 6 takime në vit. Me pa dhe me krahasu i bjen që secili ka mbajt i kanë 3 ose 4 takime shumica, kshtu që e kanë tejkalu bazen e takimeve që duhet me pas për një vjet, ata i kanë realizu për 6 muaj. Si pikë e dytë kërkësat janë më të mëdhaja në qytet dhe më të vogla në fshat, mirpo kjo qështje nuk është relivante aspak varsishtë si e sheh komunitet nevojen kërkesa drejtoven. Ndërsa sa prej tyre janë aprovu nuk është pyetje që duhet me u drejtu tek administrata, për mu ka rëndësi që është kërkësë e mirfilltë dhe protokolohet si krejt kërkësat në komunë, e ka një bazë si kryetari i këshillave lokal ose një prej anëtarëve që e drejton atë kërkësë, aty përfundon pozicioni im. Po ashtu pozicioni i administratës përfundon kur ata i sjellin procesverbalet, nënshkrimet dhe mundeni kur do me i pa edhe bashkë edhe fotot e takimeve të tyre. Po ashtu shumë shpejti kemi me bo ndryshimin e rregullores së këshillave lokal sepse ka hapsira ligjore me të cilën e përfshinë pjesen politike të njerzve, edhe unë jam pro që me u definu saktë se cilat pozicione politike nuk bën me i mbajt nese je kryetar i këshillave lokale sepse nuk është mirë e definume. Unë, kam me qenë pjesë e grupit punues dhe ka me u specifiku saktë se cilat pozicione politike nuk munden me kandidu për kryetar të këshillave lokal.

Znj.Hidajte Nikçi: fotografitë a i kanë drejtoreshë për takimet që i kanë mbajt?

Znj.Nita Panduri: po i kanë të gjitha me fotografi, me nënshkrime, emër dhe mbiemer dhe mje numra përsos, kur dëshironi ju muj me ju dokumentu.

Nga të gjithë anëtarët prezant me 6 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim informatë mbi funksionimin e këshillave lokale në Komunën e Pejës.

**8.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:**

Nuk ka pasur

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:45 h.**

Procesmbajtësja,

znj. Donjeta Morina

Donjete Morina



